

## **SHËNIMET SHPJEGUESE**

### **1. Informacion i përgjithshëm**

Digicom Sh.p.k ("Shoqëria") është krijuar më datën 18/08/2014. Shoqëria është regjistruar në autoritetet tatimore me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) L42018012R.

Kuotat e Shoqërisë zotërohen 85% nga Shoqëria Albanian Telecommunications Union Shpk (ATU) dhe 15% nga Z. Marin Gjonaj.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është ndërtim rrjetesh telekomunikacioni dhe ofrimi i shërbimeve të telekomunikacionit, internetit, telefonisë fikse, televizion me pagesë, etj. nëpërmjet sistemeve të fibrave optike.

Administrator i shoqërisë është Z. Thoma Zbogo.

Më 31 dhjetor 2020 shoqëria kishte 200 punonjës (2019: 198 punonjës).

Selia e shoqërisë është te Njësia Bashkiake nr.2, Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Tiranë.

### **2. Bazat e përgatitjes**

#### **2.1. Deklarata e Përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe legjislacionit në Shqipëri. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara në shënimin 3, të cilat janë të bazuara në kërkesat për raportim sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit ("SKK"), të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ("KKK"). Më poshtë paraqiten politikat kontabël kryesore të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Sipas SKK 11 "Mbi Tatim Fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos kontabilizoj tatimet e shtyra në pasqyrat financiare për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë paraqitur në formatin e paraqitur në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi (SKK 2).

#### **2.2. Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

#### **2.3. Monedha funksionale dhe e prezantimit**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare "Lekë", e cila është monedha funksionale. Përveç rasteve kur është shënuar ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në lekë.

#### **2.4. Parimi i Vijimësisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e vijimësisë.

Drejtimi i Shoqërisë ka arritur në përfundim se nuk ka pasiguri të qenësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë e saj në vijimësi, për të ardhmen e parashikueshme, prej të paktën 12 muajsh nga data e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare. Si rrjedhojë, Drejtimi gjykon se parimi i vijimësisë është bazë e përshtatshme në përgatitjen e këtyre pasqyrave. Supozimet e bëra nga drejtimi në lidhje me parimin e vijimësisë jepen në shënimin 4.5.

### **3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël**

#### **3.1. Instrumente financiarë**

Aktivet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen. Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

Të gjitha aktivet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Një transaksion financiar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtej afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesi që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësia duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Shoqëria ka vetem instrumenta financiare jo derivative, përfshirë llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, huamarrje, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

#### ***Mjete monetare dhe ekuivalentë***

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre. Mjetet monetare njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### ***Llogari të arkëtueshme***

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme afatshkurtra janë paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me kosto të amortizuar, pra me vlerën e koston së tyre minus zhvlerësimet e krijuara për rënie në vlerë. Zhvlerësimet e lejuara mund të llogariten, për shumat e vlerësuara si të parikuperueshme, në Pasqyrën e Performancës kur ekziston një evidencë objektive që këto kërkesa janë zhvlerësuar më parë. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme janë të mbivlerësuara. Shuma e zhvlerësimit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikura monetare të skontuara me normën efektive të interesit.

#### ***Llogari të pagueshme***

Llogaritë e pagueshme njihen me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### ***Huamarrjet***

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### ***Të tjera***

Instrumente të tjerë financiar jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### ***Vlera e drejtë***

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar, huave, përafrohet me vlerat e tyre kontabël.

**3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)****3.2. Inventaret**

Inventarët maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre Shoqëria vlereson inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësia ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Kostot e shkaktuara në sjelljen e secilit produkt në vendndodhjen dhe gjendjen e tanishme llogariten si më poshtë: kosto direkte që lidhet me inventarët dhe ato shpenzimet e përgjithshme që kanë ndodhur në sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet aktuale të tyre. Kosto e inventarit përfshin: kostoja e blerjes së mallrave, kostoja e transportit, detyrimet doganore, akciza etj.

Vlera neto e realizueshme (VNR) përfaqëson çmimin e vlerësuar të shitjes për inventarët minus të gjitha kostot e vlerësuar të kompletimit dhe kostot e nevojshme për të bërë shitjen. Drejtimi i Shoqërisë gjatë vitit monitoron periodikisht çmimet e shitjes në koston e inventarit dhe nëse çmimi ulet nën koston, diferenca njihet në Pasqyrën e Performancës si Zhvlerësim i inventarëve.

Kostoja e inventarëve bazohet në metodën e koston mesatare. Zbritja e duhur për ulje njihet në fitim dhe humbje kur ka evidencë objektive që VNR është më e ulët se kostoja.

**3.3. Aktivet afatgjata materiale dhe jo-materiale**

Aktivitet afatgjata materiale dhe jo-materiale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar.

**(i) Njohja dhe matja**

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka të tilla.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit mbarten nën aktive afatgjata jo-materiale dhe aktive financiare dhe kapitalizohen dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

**(ii) Kostot e mëpasshme**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**(iii) Amortizimi**

Amortizimi i aktiveve jo-materiale dhe përmirësimit të ambienteve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivitet e tjera afatgjata mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason mujin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet.

**3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)****3.3. Aktivet afatgjata materiale dhe jo-materiale (vazhdim)****(iii) Amortizimi (vazhdim)**

Toka nuk amortizohet.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuara janë si më poshtë:

|                                      | <b>Norma e zhvlerësimit %</b> | <b>Baza e llogaritjes</b> |
|--------------------------------------|-------------------------------|---------------------------|
| <b>Aktive afatgjata materiale</b>    |                               |                           |
| Ndërtesa                             | 5                             | Vlera kontabël neto       |
| Makineri dhe pajisje                 | 20                            | Vlera kontabël neto       |
| Mobileri dhe orendi                  | 20                            | Vlera kontabël neto       |
| Pajisje elektronike                  | 25                            | Vlera kontabël neto       |
| <b>Aktive afatgjata jo-materiale</b> |                               |                           |
| Programe kompjuterike                | 25                            | Vlera kontabël neto       |
| Të tjera aktive jo-materiale         | 15                            | Kosto                     |

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndyshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabël tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivet ose njësitë gjeneruese të parasë do të pakësohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**3.4. Zhvlerësim****(i) Aktivet financiare**

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshën për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**(ii) Aktivet jo-financiare**

Për qëllime të çmuarjes së zhvlerësimit, aktivet grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat gjenerohen flukse hyrëse parash të pavarura (njësi gjeneruese të parave). Si rezultat, disa aktive testohen individualisht për zhvlerësim dhe disa testohen në nivelin e njësisë gjeneruese të parave. Të gjitha aktivet individuale ose njësitë gjeneruese të parave testohen për zhvlerësim sa herë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë që vlera kontabël neto mund të mos rikuperohet.

**3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)****3.4. Zhvlerësim (vazhdim)****(ii) Aktivet jo-financiare (vazhdim)**

Një humbje nga zhvlerësimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e aktivitet (ose njësisë gjeneruese të parave) tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme, e cila është më e larta e vlerës së drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Për të përcaktuar vlerën në përdorim, drejtimi vlerëson flukset e parave të pritshme në të ardhmen nga secila njësi gjeneruese e parave dhe përcakton një normë të përshtatshme skontimi për të llogaritur vlerën aktuale të tyre. Të dhënat e përdorura për procedurat e testimit të zhvlerësimit janë të lidhura drejtpërdrejt me buxhetin e fundit të miratuar të Shoqërisë, të rregulluar sipas nevojës për të përjashtuar efektet e riorganizimeve dhe përmirësimeve të aktiveve në të ardhmen. Faktorët e skontimit përcaktohen individualisht për secilën njësi gjeneruese të parasë dhe pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe faktorëve të rrezikut specifik të aktiveve.

Humbjet nga zhvlerësimi për njësitë gjeneruese të mjeteve monetare ulin së pari vlerën kontabël të çdo emri të mirë të alokuar për atë njësi gjeneruese të mjeteve monetare. Çdo humbje e mbetur nga zhvlerësimi i ngarkohet proporcionalisht aktiveve të tjera në njësinë gjeneruese të mjeteve monetare. Me përjashtim të emrit të mirë, të gjitha pasuritë më pas rivlerësohen nëse ka të dhëna se një humbje nga zhvlerësimi e njohur më parë mund të mos ekzistojë më. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse shumat e rikuperueshme e aktivitet ose njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën kontabël të saj.

**3.5. Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e Shoqërisë kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë.

Të ardhurat përfshijnë shumat neto pa përfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, të cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, të ardhurat janë njohur kur është kontrolli i mallit së bashku me rreziqet dhe përfitimit që vijnë nga kontrolli, janë transferuar tek blerësi. Të ardhurat nga shërbimi njihen përgjatë kohës në përpjestim me shërbimin e ofruar ndaj klientëve.

**3.6. Të ardhura dhe shpenzime financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

**3.7. Shpenzimet**

Shpenzimet janë njohur mbi bazën e të drejtave të konstatuara. Shpenzimet për kërkime e zhvillime përgjithësisht janë ngarkuar në llogarinë e shpenzimeve në periudhën së cilës i përkasin.

**3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)****3.8. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshinë tatimin e periudhës, i cili njihet drejtëpërdrejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë periudhës.

Tatim fitimi llogaritet me 15% për vitin 2020 mbi fitimin e tatueshëm.

**3.9. Detyrime për sigurimet shoqërore**

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin.

**3.10. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

**3.11. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyera me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 ishin si më poshtë:

|       | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|-------|------------------------|------------------------|
| 1 EUR | 123.70                 | 121.77                 |
| 1 USD | 100.84                 | 108.64                 |

**3.12. Ngjarjet pas datës së raportimit**

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

#### **4. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet**

Në aplikimin e politikave kontabël të shoqërisë, që përshkruhen në Shënimin 3, nga drejtimi kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparëshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmëritë për ngjarjet e ardhëshme, të cilët besohet se janë të përshtatshme dhe relevante për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhëshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhëshme.

Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë:

##### **4.1. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare**

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen në vlerën në të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të parasë tejkalojnë vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset e parasë nga çdo njësi gjeneruese të parasë dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur kalkulohet vlera aktuale e këtyre flukseve parash.

##### **4.2. Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme.**

Drejtimi i shoqërisë në mënyrë të rregullt analizon jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në datën e pasqyrave financiare. Drejtimi vlerëson që jeta e dobishme e përcaktuar për aktivet paraqet dobishmërinë e pritshme të aktiveve.

Vlera kontabël e këtyre aktiveve është analizuar në shënimet 8 dhe 9. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve teknologjike.

##### **4.3. Inventari**

Inventari është paraqitur me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Gjatë përcaktimit të vlerës së realizueshme neto, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive/te dhënat e disponueshme për kryerjen e vlerësimeve.

##### **4.4. Tatimi mbi fitimin**

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Shoqëria njeh detyrimin në rast të një kontrolli të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jetë i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

##### **4.5. Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me parimin e vjueshmërisë, i cili nënkupton se Shoqëria do të vazhdojë operacionet e saj në një periudhë kohe të papërcaktuar, në të ardhmen e parashikuar.

**4. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)**  
**4.5. Parimi i vijmësisë (vazhdim)**



Në 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit deklaroi gjendjen e COVID-19 si një pandemi në nivel global. Duke iu përgjigjur kërcënimit që COVID-19 paraqiti për shëndetin publik, në 12 mars 2020 autoritetet qeveritare të Shqipërisë ndërmorën masa për kontrollimin e përhapjes, duke përfshirë futjen e kufizimeve në lëvizjen ndërkufitare të njerëzve, kufizimet e hyrjes për vizitorët e huaj në pritje të zhvillimeve të mëtejshme. Në veçanti, shkollat, universitetet, restorantet, kinematë, teatrot, muzetë dhe objektet sportive, shitësit me pakicë, duke përjashtuar shitësit e ushqimit, dyqanet ushqimore dhe farmacitë ishin të mbyllura. Disa biznese në Shqipëri gjithashtu udhëzuan punonjësit të qëndronin në shtëpi dhe kanë zvogëluar ose pezulluar përkohësisht operacionet e biznesit.

Ndikimet më të gjëra ekonomike të këtyre ngjarjeve përfshijnë:

- Ndërprerje në operacionet e biznesit dhe aktivitetin ekonomik në Shqipëri, me një ndikim bllokues në zinxhirët e furnizimit të brendshëm;
- Ndërprerje e konsiderueshme për bizneset në sektorë të caktuar, si brenda Shqipërisë, ashtu edhe në tregjet me varësi të lartë nga një zinxhir i furnizimit të huaj, si dhe bizneset e orientuara nga eksporti me mbështetje të lartë në tregjet e huaja. Sektorët e prekur përfshijnë tregtinë dhe transportin, udhëtimin dhe turizmin, argëtimin, prodhimin, ndërtimin, shitjen me pakicë, sigurimet, arsimin dhe sektorin financiar;
- Ulje e konsiderueshme e kërkesës për mallra dhe shërbime jo thelbësore;
- Një rritje në pasigurinë ekonomike, e reflektuar në më shumë çmime të paqëndrueshme të pronave dhe kursit të këmbimit të valutave.

Duke qenë se shoqëria ushtron aktivitetin e saj në sektorin e ofrimit të shërbimeve të telekomunikacionit, internetit, telefonisë fikse, televizion me pagesë, etj. pandemia dhe kufizimi i lëvizjeve ndikoi në rritje të kërkesës për shërbimet e ofruara nga shoqëria që u reflektua edhe në performancën financiare të shoqërisë. Shoqëria pati impakt në rritje të fitimit si pasojë e rritjes së të ardhurave nga aktiviteti kryesor me 37%. Gjithashtu për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 shoqëria rezultoi me fitim pas tatimit në vlerën 13,355,898 lekë.

Si rrjedhojë, drejtimi parashikon që Shoqëria do të ketë burime të mjaftueshme për të siguruar vijueshmërinë e biznesit për një periudhë të paktën 12 muaj nga data e raportimit. Drejtimi arriti në përfundimin se tërësia e rezultateve të mundshme të konsideruara për të arritur në këtë gjykim nuk krijon paqartësi materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të mëdha në aftësinë e Shoqërisë për të vijuar aktivitetin.

   
NIP: L42010012  
Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Tiranë



**5. Mjete monetare**

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                            | <b>31 dhjetor 2020</b>   | <b>31 dhjetor 2019</b>  |
|----------------------------|--------------------------|-------------------------|
| Arka                       |                          |                         |
| - në monedhë vendase       | 1,856,177                | 702,081                 |
| - në monedhë të huaj       | 146,320                  | 43,014                  |
|                            | <u><b>2,002,497</b></u>  | <u><b>745,095</b></u>   |
| Llogari rrjedhëse në banka |                          |                         |
| - në monedhë vendase       | 83,914,496               | 5,458,623               |
| - në monedhë të huaj       | 3,609,507                | 662,221                 |
|                            | <u><b>87,524,003</b></u> | <u><b>6,120,844</b></u> |
| Mjete monetare në tranzit  |                          |                         |
| - ATM                      | 100,990                  | 43,980                  |
| - Paypal                   | 802,211                  | 229,402                 |
|                            | <u><b>903,201</b></u>    | <u><b>273,382</b></u>   |
| <b>Totali</b>              | <u><b>90,429,701</b></u> | <u><b>7,139,321</b></u> |

**6. Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                     | <b>31 dhjetor 2020</b>    | <b>31 dhjetor 2019</b>    |
|---------------------|---------------------------|---------------------------|
| Klientë Biznes      | 80,833,505                | 55,546,227                |
| Klientë Mikrobiznes | 12,085,524                | 13,294,173                |
| Klientë Rezidencial | 31,752,266                | 35,264,769                |
| <b>Totali</b>       | <u><b>124,671,295</b></u> | <u><b>104,105,169</b></u> |

Drejtimi i shoqërisë nuk ka njohur zhvlerësim për borxhin e keq.

**7. Llogari të tjera të arkëtueshme**

Llogari të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                                     | <b>31 dhjetor 2020</b>   | <b>31 dhjetor 2019</b>  |
|-------------------------------------|--------------------------|-------------------------|
| Parapagime per furnitore            | 33,977,222               | 3,375,509               |
| Shpenzime te periudhave te ardhshme | 3,460,566 ✓              | 3,312,184               |
| Garanci bankare ndaj A.M.A          | -                        | 1,000,000               |
| Te drejta nga pale te lidhura       | 368,796                  | 230,458                 |
| Tatim fitimi i parapaguar           | -                        | 58,060                  |
| Llogari Dogane                      | 17,873                   | 24,626                  |
| Te tjera                            | 2,463,318                | 1,133,546               |
| <b>Totali</b>                       | <u><b>40,287,775</b></u> | <u><b>9,134,383</b></u> |

**8. Inventarë**

Inventarët më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:


|                               | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|-------------------------------|------------------------|------------------------|
| Materiale konsumi dhe të imta | 904,034                | 267,469                |
| Materiale promocionale        | -                      | -                      |
| Produkte e mallra             | 2,322,024              | 2,297,782              |
| <b>Totali</b>                 | <b>3,226,058</b>       | <b>2,565,251</b>       |

### 9. Investime financiare afatgjata

Investime financiare afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                            | <b>Kuota %</b> | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|----------------------------|----------------|------------------------|------------------------|
| Investimi tek ADA Net shpk | 100            | 100,000                | 100,000                |
| <b>Total</b>               |                | <b>100,000</b>         | <b>100,000</b>         |

Digicom ka blerë 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë ADA Net shpk më 06 Tetor 2014.



**DIGICOM sh.p.k**

**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020**

(Të gjithë shumat janë në lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

**10. Aktive afatgjata materiale**

Aktive afatgjata materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

| <i>Kosto Historike</i>            | Instalime të përgjithshme | Paisje zyre dhe informatike | Mjetet e Transportit | Përmirësime të qirasë | Aktive në Proces  | Total              |
|-----------------------------------|---------------------------|-----------------------------|----------------------|-----------------------|-------------------|--------------------|
| Më 1 janar 2019                   | 252,182,570               | 19,308,493                  | 10,370,302           | -                     | 26,901,603        | 308,762,968        |
| Shtesa                            | -                         | -                           | -                    | -                     | 174,293,509       | 174,293,509        |
| Pakësime                          | (5,333,893)               | (5,167)                     | -                    | -                     | (2,491,118)       | (7,830,178)        |
| Transferime nga aktivet në proces | 119,207,093               | 6,266,365                   | 4,033,426            | 6,169,021             | (135,675,905)     | -                  |
| <b>Më 31 dhjetor 2019</b>         | <b>366,055,770</b>        | <b>25,569,691</b>           | <b>14,403,728</b>    | <b>6,169,021</b>      | <b>63,028,089</b> | <b>475,226,299</b> |
| Shtesa                            | -                         | -                           | -                    | -                     | 104,724,909       | 104,724,909        |
| Pakësime                          | (3,649,899)               | -                           | -                    | -                     | (3,421,300)       | (7,071,199)        |
| Transferime nga aktivet në proces | 107,573,812               | 2,186,002                   | 3,181,770            | 78,918                | (113,020,502)     | -                  |
| <b>Më 31 dhjetor 2020</b>         | <b>469,979,683</b>        | <b>27,755,693</b>           | <b>17,585,498</b>    | <b>6,247,939</b>      | <b>51,311,196</b> | <b>572,880,009</b> |

*Amortizimi i Akumuluar*

|                           |                      |                     |                    |                    |          |                      |
|---------------------------|----------------------|---------------------|--------------------|--------------------|----------|----------------------|
| Më 1 janar 2019           | (41,227,058)         | (8,133,722)         | (4,525,127)        | -                  | -        | (53,885,907)         |
| Amortizimi i Vitit        | (30,359,446)         | (2,851,186)         | (1,575,693)        | (314,900)          | -        | (35,101,225)         |
| Pakësime                  | 2,582,943            | 2,387               | -                  | -                  | -        | 2,585,330            |
| <b>Më 31 dhjetor 2019</b> | <b>(69,003,561)</b>  | <b>(10,982,521)</b> | <b>(6,100,820)</b> | <b>(314,900)</b>   | <b>-</b> | <b>(86,401,802)</b>  |
| Amortizimi i Vitit        | (41,501,904)         | (3,386,292)         | (1,781,767)        | (1,182,324)        | -        | (47,852,287)         |
| Pakësime                  | 2,055,128            | -                   | -                  | -                  | -        | 2,055,128            |
| <b>Më 31 dhjetor 2020</b> | <b>(108,450,337)</b> | <b>(14,368,813)</b> | <b>(7,882,587)</b> | <b>(1,497,224)</b> | <b>-</b> | <b>(132,198,961)</b> |

*Vlera e Mbetur*

|                           |                    |                   |                  |                  |                   |                    |
|---------------------------|--------------------|-------------------|------------------|------------------|-------------------|--------------------|
| <b>Më 31 dhjetor 2019</b> | <b>297,052,208</b> | <b>14,587,170</b> | <b>8,302,909</b> | <b>5,854,121</b> | <b>63,028,089</b> | <b>388,824,497</b> |
| <b>Më 31 dhjetor 2020</b> | <b>361,529,346</b> | <b>13,386,881</b> | <b>9,702,911</b> | <b>4,750,716</b> | <b>51,311,195</b> | <b>440,681,048</b> |

Aktivitet afatgjata materiale dhe jomateriale regjistronen fillimisht si aktive në proces dhe më pas klasifikohen si aktive afatgjata materiale dhe jomateriale kur janë gati për përdorim.



**DIGICOM sh.p.k****Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020***(Të gjithë shumat janë në lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)***11. Aktive afatgjata jomateriale**


Aktivet afatgjata jomateriale më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                                   | Aktive jomateriale  | Aktive jomateriale<br>në Proces | Totali              |
|-----------------------------------|---------------------|---------------------------------|---------------------|
| <b>Kosto Historike</b>            |                     |                                 |                     |
| Më 1 janar 2019                   | 28,530,104          | -                               | 28,530,104          |
| Shtesa                            | -                   | 19,154,653                      | 19,154,653          |
| Pakesime                          | -                   | -                               | -                   |
| Transferime nga aktivet në proces | 19,154,653          | (19,154,653)                    | -                   |
| <b>Më 31 dhjetor 2019</b>         | <b>47,684,757</b>   | -                               | <b>47,684,757</b>   |
| Shtesa                            | -                   | 2,466,346                       | 2,466,346           |
| Pakesime                          | -                   | -                               | -                   |
| Transferime nga aktivet në proces | 2,466,346           | (2,466,346)                     | -                   |
| <b>Më 31 dhjetor 2020</b>         | <b>50,151,103</b>   | -                               | <b>50,151,103</b>   |
| <b>Amortizimi i Akumuluar</b>     |                     |                                 |                     |
| Më 1 janar 2019                   | (5,160,439)         | -                               | (5,160,439)         |
| Amortizimi i Vitit                | (7,322,621)         | -                               | (7,322,621)         |
| Pakesime                          | -                   | -                               | -                   |
| <b>Më 31 dhjetor 2019</b>         | <b>(12,483,060)</b> | -                               | <b>(12,483,060)</b> |
| Amortizimi i Vitit                | (8,936,280)         | -                               | (8,936,280)         |
| Pakesime                          | -                   | -                               | -                   |
| <b>Më 31 dhjetor 2020</b>         | <b>(21,419,340)</b> | -                               | <b>(21,419,340)</b> |
| <b>Vlera e Mbetur</b>             |                     |                                 |                     |
| <b>Më 31 dhjetor 2019</b>         | <b>35,201,697</b>   | -                               | <b>35,201,697</b>   |
| <b>Më 31 dhjetor 2020</b>         | <b>28,731,763</b>   | -                               | <b>28,731,763</b>   |

**12. Llogari të pagueshme**

Llogarit e pagueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                   | 31 dhjetor 2020    | 31 dhjetor 2019    |
|-------------------|--------------------|--------------------|
| Furnitore te Huaj | 216,363            | 2,867,284          |
| Furnitore Vendas  | 343,303,257        | 291,193,219        |
| <b>Total</b>      | <b>343,519,620</b> | <b>294,060,503</b> |



**13. Detyrime të tjera**

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                                      | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|--------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Garanci për pajisje në përdorim      | 26,872,990 ✓           | 21,035,649             |
| Furnitore për fatura të pambërritura | 574,898 ✓              | 270,471 ✓              |
| Kosto Personeli                      | 8,372,527 ✓ +          | 8,114,872              |
| TVSH e pagueshme                     | 6,012,766              | 1,455,025              |
| Sigurime shoqërore dhe shendetesore  | 2,751,848 ✓ +          | 3,447,594              |
| Tatim në burim dhe TAP               | 650,584                | 1,154,049              |
| Tatim fitimi                         | 2,314,060              | -                      |
| <b>Total</b>                         | <b>47,549,673</b>      | <b>35,477,660</b>      |

Shoqëria merr garanci nga klientët për të garantuar mbarëvajtjen e paisjeve të vëna në përdorim. Vlera e garancisë i kthehet klientit në momentin e mbylljes së kontratës.

**14. Të ardhura të marra në avancë**

Të ardhura të marra në avancë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|  | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|--|------------------------|------------------------|
| Te ardhura të shtyra Internet dhe IPTV | 38,775,641             | 60,170,582             |
| Kreditor për parapagime të marra       | 1,637,626              | 1,305,526              |
| <b>Total</b>                           | <b>40,413,267</b>      | <b>61,476,108</b>      |

Të ardhurat e marra në avancë lidhen me pagesa të bëra kryesisht për kontrata nga një deri në dy vjet për shërbime internet dhe IPTV.

**15. Huamarrje dhe qira financiare**

Huamarrje dhe qira financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                                      | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|--------------------------------------|------------------------|------------------------|
| <b>Huamarrje afat-shkurtër</b>       |                        |                        |
| Qira Financiare                      | -                      | 5,162,056              |
| Kësti afatshkurtër i huasë afatgjatë | 18,787,698             | -                      |
| <b>Total huamarrje afat-shkurtër</b> | <b>18,787,698</b>      | <b>5,162,056</b>       |
| <b>Huamarrje afat-gjatë</b>          |                        |                        |
| Huamarrje afatgjate                  | 113,607,493            | -                      |
| Ortaku Marin Gjonaj                  | 3,234,861              | 3,234,861              |
| <b>Total huamarrje afat-gjatë</b>    | <b>116,842,354</b>     | <b>3,234,861</b>       |
| <b>Total</b>                         | <b>135,630,052</b>     | <b>8,396,917</b>       |



NIPIT: L4201201

Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Tiranë



**16. Të ardhura**

Shoqëria ofron shërbime interneti, telefoni dhe IPTV për individë dhe kompani. Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|   | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|---|------------------------|------------------------|
| Të ardhura nga shërbime telekomunikacioni brenda vendit | 385,028,075            | 279,490,261            |
| Të ardhura nga shërbime telekomunikacioni jashte vendit | 6,526                  | 1,233,793              |
| Të tjera  | 9,263,697              | 6,705,673              |
| <b>Total</b>  | <b>394,298,298</b>     | <b>287,429,727</b>     |

**17. Të ardhura të tjera**

Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                                  | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|----------------------------------|------------------------|------------------------|
| Te ardhura nga shitja e aktiveve | 3,765,047              | 7,770,133              |
| Të tjera                         | 1,445,856              | 10,422,591             |
| <b>Total</b>                     | <b>5,210,903</b>       | <b>18,192,724</b>      |

**18. Furnizim material dhe shërbime**

Kosto e materialeve, kosto aksesi në internet dhe shpenzime të tjera direkte për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                              | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|------------------------------|------------------------|------------------------|
| Kosto aksesi në internet     | 25,669,859             | 21,674,213             |
| Të drejta TV                 | 14,647,538             | 7,208,831              |
| Kosto telefonie              | 18,416,966             | 21,600,882             |
| Qira dhe shpenzime utilitare | 6,210,415              | 1,416,727              |
| Riparime dhe mirëmbajtje     | 13,131,543             | 8,227,035              |
| Blerje materiale             | 1,785,147              | 9,595,559              |
| Të tjera                     | 398,928                | 299,787                |
| <b>Total</b>                 | <b>80,260,396</b>      | <b>70,023,034</b>      |

**19. Shpenzime personeli**

Shpenzimet për personelin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|                                      | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|--------------------------------------|------------------------|------------------------|
| Paga dhe shpërblime                  | 110,010,581            | 107,138,319            |
| Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore | 17,783,164             | 17,312,826             |
| <b>Total</b>                         | <b>127,793,745</b>     | <b>124,451,145</b>     |

**20. Shpenzime të tjera operative**

Shpenzimet administrative dhe të tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

|  | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|--|------------------------|------------------------|
| Shpenzime utilitare dhe qera           | 39,679,127             | 36,771,305             |
| Shpenzime marketingu                   | 52,145,797             | 40,259,399             |
| Shitje e aktiveve afatgjata            | 2,727,669              | 3,636,232              |
| Tarifa dhe licenca                     | 4,006,584              | 4,993,607              |
| Shërbime profesionale dhe të tjera     | 703,324                | 1,212,224              |
| Blerje materiale konsumi administrativ | 756,639                | 1,229,408              |
| Komision shitje                        | 5,436,622              | 5,096,598              |
| Taksa te tjera                         | 936,301                | 857,325                |
| Komisione bankare                      | 3,236,616              | 1,476,991              |
| Trajnime dhe evente BNJ                | 92,149                 | 1,074,415              |
| Kosto transporti                       | 1,655,126              | 2,449,257              |
| Honorare                               | -                      | 30,814                 |
| Të tjera                               | 5,793,894              | 5,405,575              |
| <b>Total</b>                           | <b>117,169,848</b>     | <b>104,493,150</b>     |

**21. Të ardhura/(shpenzimet) financiare**

Të ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara apo të porealizuara nga kurset e këmbimit, të ardhurat dhe shpenzimet nga interest dhe të tjera të ardhura financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 dhe paraqiten si më poshtë:

|  | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|--|------------------------|------------------------|
| Shpenzime interesti                                  | (288,651)              | (365,791)              |
| Humbje nga kursi i kembimit                          | (1,916,028)            | (319,474)              |
| <b>Shpenzime Financiare:</b>                         | <b>(2,204,679)</b>     | <b>(685,265)</b>       |
| Te ardhura nga interesti                             | 176                    | 314                    |
| Fitim nga kursi i kembimit                           | 457,647                | 207,249                |
| <b>Te ardhura Financiare:</b>                        | <b>457,823</b>         | <b>207,563</b>         |
| <b>Totali të ardhura/(shpenzime) financiare neto</b> | <b>(1,746,856)</b>     | <b>(477,702)</b>       |



**DIGICOM sh.p.k****Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020***(Të gjithë shumat janë në lekë, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)***22. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatim fitimit rakordon me fitimin kontabël për vitet 2020 dhe 2019 si më poshtë:

|   | <b>31 dhjetor 2020</b> | <b>31 dhjetor 2019</b> |
|---|------------------------|------------------------|
| 1 Fitimi/(Humbja) para tatimit                  | 15,749,789             | (36,246,426)           |
| 2 Shpenzime te panjohura                        | 209,481                | 5,096,509              |
| 3 Te ardhura te pa tatueshme                    | -                      | -                      |
| <b>4 Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3)</b>  | <b>15,959,270</b>      | <b>(31,149,917)</b>    |
| 5 Humbje te mbartura (-)                        | -                      | -                      |
| 6 Fitimi / (humbje) e tatueshme                 | 15,959,270             | (31,149,917)           |
| 7 Norma e tatimit mbi fitimin                   | 15%                    | 15%                    |
| <b>8 Shpenzim tatim fitimi</b>                  | <b>2,393,891</b>       | <b>-</b>               |
| 9 Tatim fitimi i mbartur                        | -                      | 210,895                |
| 10 Tatim fitimi i parapaguar                    | 79,831                 | 268,955                |
| <b>11 Tatim fitimi i pagushem (arketueshem)</b> | <b>2,314,060</b>       | <b>(58,060)</b>        |

**23. Detyrime të kushtëzuara*****Detyrime tatimore***

Librat dhe të dhënat kontabël për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2020 nuk janë audituar nga ana tatimore.

***Çështje gjyqësore***

Në datën e mbylljes së pasqyrave financiare në 31 dhjetor 2020, nuk ka asnjë çështje gjyqësore të ngritur kundër shoqërisë Digicom Shpk.

**24. Ngjarje pas datës së raportimit**

Qeveria shqiptare në 2021 ka njoftuar masat e reja të kufizimeve të lëvizjes që do të hyjnë në fuqi duke filluar nga data 11 shkurt 2021, deri në një njoftim tjetër. Këto masa parashikojnë kufizim të lëvizjeve nga ora 20:00 deri në 6:00. Lëvizja publike është e kufizuar gjatë këtyre orëve me përjashtim të arsyeve të punës, emergjencave të kujdesit shëndetësor ose nevojave urgjente. Kufizimi i udhëtimit vazhdon të jetë i zbatueshëm.

Shoqëria ka përcaktuar që këto ngjarje janë ngjarje pas datës së bilancit të cilat nuk kërkojnë korrigjime. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e aktiviteteve më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 nuk janë korigjuar për të pasqyruar ndikimin e tyre. Kohezgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjive të qeverisë dhe bankës qendrore, mbetet i paqartë në këtë kohë.

Nuk ka pasur asnjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit, e cila kërkon dhënie informacioni shtesë apo ndonjë rregullim në pasqyrat financiare.

